Organization for Security and Co-operation in Europe
Office for Democratic Institutions and Human Rights

Ul. Miodowa 10
00-251 Warsaw, Poland

Tel: +48 22 520 06 00
Fax: +48 22 520 06 05

E-mail: bpri@odihr.pl
osce.org/odihr

Raport nga Tryeza e Rrumbullakët në Nivel Rajonal mbi Banimin e Romëve

12-13 shtator 2012

Zagreb, Kroaci

Mbi projektin

"Praktikat më të mira për integrimin e romëve" (PMIR) është projekt rajonal për Ballkanin Perëndimor. Ky projekt ka për qëllim të kontribuojë në integrimin e romëve në shtetet e rajonit dhe në Kosovë*, duke i shqyrtuar zotimet e bëra me qëllim të bashkimit në BE dhe si shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian (90%) dhe shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së (10%).

Në suazat e Planit të Veprimit të OSBE-së për Komunitetin Rom dhe Sinti, Dekadën e Përfshirjes së Romëve dhe strategjitë qeveritare për integrimin e romëve, qeveritë, organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile rome në Ballkanin Perëndimor janë duke punuar së bashku për promovimin e përfshirjes sociale për romët dhe luftimin e diskriminimit ndaj tyre.

Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim e BE-së ka mbajtur një sërë konferencash të nivelit të lartë për romët bashkë me të gjitha qeveritë në rajon, që ka rezultuar në një numër konkludimesh dhe zotimesh. Që romët të përfitojnë në të vërtetë nga këto, qeveritë duhet t'i shtojnë përpjekjet e tyre dhe të gjejnë zgjidhje inovative. Organizatat e shoqërisë civile, dhe në veçanti OJQ-të rome, duhet të vazhdojnë me aktivitete avokuese për reformim, duke propozuar zgjidhje me përfshirëse dhe duke rritur ndërgjegjësimin lidhur me gjendjen e pakicës rome.

Projekti PMIR do ta mbështesë këtë proces përmes promovimit të programeve inovative dhe përmes lehtësimit të bashkëpunimit ndërmjet qeverive lokale dhe qendrore, institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile. Banimi është një nga pesë fushat në të cilat do të punojë PMIR, të clat fusha janë: 1. Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike dhe vendimmarrje; 2. Qasja në ndihmë juridike; 3. Përmirësimet e kushteve të jetës; 4. Luftimi i diskriminimit dhe promovimi i vizibilitetit për komunitetin rom; dhe 5. Bashkëpunimi rajonal.

Objektivat e tryezës së rrumbullakët

Objektivi i tryezës së rrumbullakët është të mbështesë qeveritë dhe shoqërinë civile në përmirësimin e mekanizmave kombëtare dhe lokale për legalizimin dhe përmirësimin e vendbanimeve rome. Për shkak se legalizimi dhe përmirësimi nuk janë opsione të realizueshme në të gjitha vendbanimet, tryeza e rrumbullakët gjithashtu do të nënvizojë lidhjet e mundshme me nismat për zhvillimin e banimit social. Duke sjellë në një vend ekspertë nga ministri dhe komuna të cilët do të punojnë në fushën e banimit, kjo tryezë e rrumbullakët do të:

- promovojë një këmbim të përvojave me modele të ndryshme të përmirësimeve të banimit;
- ofrojë ndërgjegjësim lidhur me zhvillimin e banimit social dhe realizimin e të drejtave të banimit;
- trajtojë vështirësitë në integrimin e romëve përkitazi me zhvillimet në fushën e banimit.

* Ky emërtim është pa kurrëfar paragjykime ndaj pozitave lidhur me statusin dhe është në pajtim me UNSCR 1244/99 dhe mendimin e ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Pjesëmarrësit

Pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët ishin përfaqësues të më tepër se 20 komunave, duke përfshirë koordinatorët dhe referentët romë (aty ku ka), 7 ministri përgjegjëse për planifikim hapsinor dhe/ose të drejta të pakicave, asociacione të komunave, organizata joqeveritare dhe ekspertë të tjerë që punojnë në çështjet e banimit.

Historiku

Definicioni punues i OSBE-së për vendbanimin e ndërtuar në mënyrë të paligjshme është "çdo vendbanim njerëzor ku banimi është ndërtuar pa lejen e nevojshme apo titullin ligjor për shfrytëzimin e tokës."[1] Çështja e legalizimit të vendbanimeve joformale rome është një nga shqetësimet më urgjente e identifikuar në *Planin e Veprimit të OSBE-së të vitit 2003 për Përmirësimin e Gjendjes së Komunitetit Rom dhe Sinti përbrenda Fushëveprimit të OSBE-së*.[2] Në shumicën e juridiksioneve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, banimi ligjor është parakusht për përmbushjen e të drejtave tjera. Romët që jetojnë në vendbanime joformale kanë mungesë të qasjes së arsyeshme në tokën dhe pronën të cilën e kanë në shfrytëzim dhe prandaj i janë të ekspozuar dëbimit. Gjithashtu, ata përballen me vështirësi në qasjen në regjistrin civil, arsim dhe shërbime të tjera publike. Zgjidhja e çështjeve të banimit dhe vendbanimit është e nevojshme për të luftuar margjinalizimin dhe përjashtimin social.

Zhvillimi i banimit dhe përmirësimit të vendbanimeve të cilat janë pjesë e vendbanimeve rome, duhet të zbatohet në pajtim me 10 parimet e përbashkëta bazike për përfshirjen e romëve, të cilat mes tjerave përfshijnë edhe përdorimin e instrumenteve të Bashkimit Evropian dhe pjesëmarrjen aktive të romëve.

Vendbanimet joformale rome janë të pranishme në të gjitha juridiksionet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në vitin 2002, Misioni i OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë identifikoi rreth njëqind vendbanime joformale të romëve në mbi tridhjetë komuna, me një popullatë prej rreth 22,000 personash. Në Serbi, prej rreth 590 vendbanimeve rome, vlerësohet se rreth 35% janë të ndërtuara në mënyrë joligjore, gjersa rreth 35% të tjera janë kombinim i vendbanimit joligjor dhe ligjor.[3] Megjithatë, në shumicën e juridiksioneve mungojnë të dhëna të sakta për numrin dhe kushtetet e jetesës në vendbanimet rome.

Përmbledhje e prezantimeve

- <u>*Legalizimi i vendbanimeve joligjore (Rome) sipas ligjit dhe në praktikë*</u>, Z. Zharko Haxhi-Zafirov, Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Ri, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

  Rritja e numrit të ndërtimeve joligjore dhe problemeve infrastrukturore gjatë dy dekadave të fundit, e bëri qeverinë që të miratojë Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve Joligjore në vitin 2011. Afati për dorëzimin e aplikacioneve për legalizim ishte 6 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit. Gjatë kësaj periudhe (mars-shtator 2011), u dorëzuan 353,800 kërkesa për legalizim (20% në Shkup).

  Kërkesa për legalizim duhet të shoqërohet nga një çertifikatë për nënshtetësi ose kopje të letërnjoftimit, si dhe vërtetim për ndërlidhshmërinë ose fatura për shërbimet publike (rrymë, ujë etj). Në rast të pamundësisë për të siguruar vërtetim për shërbimet publike, alternativë tjetër është që aplikuesi të sigurojë deklaratë nga noteri e cila konfirmon se objekti është ndërtuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit.

  Në komunat me numër të madh të popullatës rome (kryesisht Shuto Orizare, Shtip, Prilep dhe Kumanovë), u dorëzuan rreth 45,800 aplikacione (rreth 13% u miratuan). Pjesëmarrja e romëve në procesin e legalizimit u vështirësua nga çmimi i lartë i raportit për vlerësimin e tokës (100 euro

[1] Misioni i OSBE në Bosnjë dhe Hercegovinë, *Raport për vendbanimet joformale rome në Bosnjë dhe Hercegovinë*, 2003, f.3. http://www.osce.org/node/14860.
[2] Plani veprues i OSBE-së për përmirësimin e gjendjes së romëve dhe sintive në kornizat e fushëveprimeve të OSBE-së http://www.osce.org/odihr/17554.
[3] Udhëzime për përmirësimin e legalizimit të vendbanimeve joformale rome. http://www.romadecade.org/files/downloads/14th%20ISC/Guidelines%20ISC%204-5%20Sept%2008%20Macura.pdf.

krahasuar me ndihmën mesatare sociale prej 25 euro në muaj), të drejtat e parregulluara lidhur me pronësinë dhe mungesën e dokumenteve tjera (p.sh. fatura të paguara për shërbimet komunale).

- *Sigurimi i integrimit të romëve në banimin social*, Z. Marko Canoviç, ndihmës ministër, Ministria për Turizëm dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, Qeveria e Malit të Zi

  Qeveria e Malit të Zi tani është duke punuar në propozim ligjin për banim social – në vijim është një debat publik dhe shpresohet që ligji të miratohet pas zgjedhjeve të 14 tetorit. Shfrytëzuesit e banimit social janë njerëz të cilët nuk mund t'i paguajnë shtëpitë sipas çmimeve të tregut. Megjithatë është duke u diskutuar ajo se a duhet romët të përmenden në ligj si një target grup i posaçëm. Banimi social nuk është një iniciativë e re në Mal të Zi, ndërsa ligji ka për qëllim që të mundësojë një kornizë dhe rregullim më të fortë ligjor.

  Në plotësim të ndërtimit të njësive të reja për banim social, propozim ligji gjithashtu përcakton masa tjera siqë janë subvencionet për blerjen e banesave, duke i dhënë për çmime që janë më të ulta se ata në treg, kredi afatgjate për korporatat ose partneritetet publiko-private etj.

  Zhvillimi i Programit Kombëtar për Banim Social dhe programeve lokale është paraparë për të qenë metoda për planifikimin e resurseve buxhetare. Propozim ligji parasheh themelimin e agjencive për banim, të cilat do t'i mirëmbajnë njësitë e banimit social, do të përcaktojnë kritere etj. Disa komuna do të kenë mundësi të krijojnë një agjenci të përbashkët për banim.

  Mali i Zi gjithashtu merr pjesë në Procesin e Sarajevës i cili filloi në vitin 2005. Qeveria propozoi projekte për vendbanimin Konik në Podgoricë, i cili përfshin 90 njësi banuese.

  Në bashkëpunim me një korporatë italiane themelohet një bankë për kursime banuese. Njerëzit do të kenë mundësi që për një kohë të kursejnë dhe pastaj të fitojnë një kredi me interes të ulët për blerjen ose furnizimin e njësive të tyre banuese. Ky lloj i zgjidhjes inovative është i nevojshëm për shkak se njerëzve në Mal të Zi u nevoiten 2.5 rroga mesatare për të blerë 1m^2. Shumica nuk mund të marrin kredi me interesin aktual. Deri më sot, banimi social u është mundësuar 430 familjeve (1,100 njerëz).

  Qeveria e Malit të Zi është gjithashtu aktive në fushën e legalizimit. Është vlerësuar se në vend ka 100,000 objekte banuese joligjore. Stabiliteti seizmik i këtyre objekteve është një nga brengat kryesore. Ligji për legalizim u ndërlidh me orto fotografinë, e cila e krijoi bazën – çdo gjë e ndërtuar pas atij momenti (dhe e cila nuk është në fotografi) nuk mund të legalizohet. Afati për aplikimin për legalizim është 9 muaj. Aplikantët mund ta paguajnë tokën me këste gjatë një periudhe 20 vjeçare për një rezidencë primare (10 vite nëse nuk është rezidenca e tyre primare). Komunat do të marrin hua sipas këtij sistemi dhe do ta ndërtojnë infrastrukturën e nevojshme.

- *Sfidat në zhvillimin urban dhe integrimin e romëve,* Znj. Svetllana Ristiç, këshilltare, Ministria për Ndërtim dhe Zhvillim Urban, Qeveria e Serbisë

  Në vitin 2001, Qeveria e Serbisë inicoi një studim hulumtues për vendbanimet rome në këtë shtet. Ky raport [4] identifikoi 593 vendbanime me 247,591 banorë (duke përfshirë edhe 19% persona të zhvendosur brenda vendit). 4.7% nga vendbanimet u përcaktuan për të qenë si substandarde (43.5% "johigjienike" dhe 41.2% parcialisht të ekuipuara). 19% nga objektet banuese ishën të karakterizuara si "jo të denja për banim".

  Korniza ligjore në Serbi evuloi nga miratimi i Planit Kombëtar për Veprim për Banimin e Romëve në vitin 2005, në *Udhëzime për Legalizimin dhe Përmirësimin e Vendbanimeve Rome në vitin* 2007, duke kulminuar me miratimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Gjendjes së Romëve në vitin 2009 (duke përfshirë edhe një plan të azhuruar për banim). Strategjia përcakton objektiva të cilat përfshijnë rindërtimin dhe legalizimin e vendbanimeve rome, integrimin më të madh të bashkësive rome, përmirësimin e vazhdueshëm të kornizës ligjore dhe të tjera.

  Në nivel lokal, qeveria financoi zhvillimin e 10 planeve të rregullimit të detajuar në 8 komuna. Katër plane janë miratuar (në komunat Srbobran, Knjazhevac, Opovo dhe në qytetin e Nishit), tre janë duke u rishqyrtuar dhe tre të tjera janë duke u përpiluar. Qeveria do të vazhdojë ta financojë zhvillimin e dokumenteve teknike (ndarja e tokës në parcela, projekte infrastrukturore etj.), në komunat të cilat kanë miratuar plane vepruese. Megjithatë, në disa komuna ka mungesë të interesit për këtë proces.

[4] B. Jakshiq dhe G. Bashiq, Vendbanime rome, Kushte dhe mundësi jetësore për integrimin e romëve në Serbi, 2002.

Përkrahja gjithashtu do të vazhdojë përmes IPA 2012, me çfarë do të mundësohet krijimi i një databaze hapsinore për vendbanimet e romëve, do të vazhdohet financimi i planeve urbane dhe dokumentacionit teknik si një parakusht për legalizim, dhe do të mundësohet trajnim dhe rritje e vetëdijes për rëndësinë e legalizimit. Prioritet u jepet projekteve banuese në të cilat përfshihet vetëndihma për ndërtim. Atje ku legalizimi nuk është i mundshëm do të zbatohet rivendosje dhe ndërtim/përshtatje e banesave.

Përfitimet nga legalizimi përfshijnë:

- Komunat të cilat kanë miratuar plane urbane, kanë krijuar kushte për tërhekjen e fondeve shtesë për projekte infrastrukturore;
- Procesi i legalizimit krijon kushtet bazike për dhënien e përkrahjes për amvisëri/familje individuale;
- Procesi i legalizimit gjithashtu i inkurajon amvisëritë që të punojnë në mënyrë më aktive për gjendjen e tyre banuese (e rrit ndjenjën e pronësisë ndaj këtij projekti);
- Legalizimi i zvoglon burimet e konfliktit dhe marrëdhëniet sociale bëhen më stabile;
- Legalizimi mundëson zhvillimin e zgjidhjeve afatgjata dhe të qëndrueshme.

Para një kohe, qyteti i Beogradit inicoi rivendosjen e vendbanimeve rome në lokacione qendrore (nën urën Gazela dhe në lagjen Belvil). Përgatitja për krijimin e zgjidhjeve të qëndrueshme banuese për familjet e rivendosura është në vijim, por mungojnë plane adekuate urbane dhe tokë e lirë dhe e paisur për këtë ndërtim. Në plotësim, është e nevojshme që rivendosja të qaset si një proces gjithëpërfshirës – duke përfshirë qasjen në punësim, arsim dhe kujdes shëndetësor – me qëllim që të sigurohet një sukses afatgjatë.

❖ *Përdorimi i IPA fondeve për ta përmirësuar infrastrukturën në vendbanimet rome: shembulli i Mexhimurjes*, Z. Aleksa Xhokiç, udhëheqës departamenti, Zyra Qeveritare për Pakica Kombëtare, Qeveria e Kroacisë

Në vitin 2005, qeveria bëri një hulumtim bazik dhe botoi dy raporte për romët[5]. Hulumtimi i amvisërive në vitin 2011 zbuloi se Kroacia është shteti i cili ka pabarazi më të madhe mes qasjes së popullatës së përgjithshme përkitazi asaj rome në sanitacionin e përmirësuar dhe burimet e ujit të përmirësuara.

Korniza ligjore e përfshin Programin Kombëtar të Romëve (2003) dhe Planin Veprues të Dekadës së Romëve (2005) të cilat kanë kapituj për banim (më shumë të fokusuara në shtëpitë në pronësi private). Kjo u ndoq nga planet e qarqeve për përmirësimin e gjendjes banuese – të gjitha 14 qarqet i përgatitën planet e tyre mes 2005 dhe 2010, dhe tani aktivitetet kryesisht gjenden në duart e pushteteve lokale.

Ministria për Ndërtim dhe Planifikim Hapsinor deri më tani ka financuar rreth 14 plane urbane dhe komunave u dhuroi tokë e cila u transferua tek pronarët rom të shtëpive. Romët u çliruan nga gjobat për objektet joligjore dhe fituan kredi me interes të ulët për tu bashkangjitur në rrjetin komunal. Para një kohe u miratua një ligj i ri për legalizim.

Në sferën e banimit social, mungesa e strategjisë/ligjit është disi e kompenzuar nga disa shembuj të programeve për banim, si dhe furnizimi me ushqim për nevojat e personave të cilët gjenden në rrezik nga përjashtimi social (romët nuk përmenden në mënyrë të posaçme). Përkrahja gjithashtu mundësohet nga pushtetet lokale, në bashkëpunim me zyrat për punë sociale dhe këshillet/OJQ rome, duke përfshirë edhe subvencione për qira, nxemje, ujë, mbeturina, meremetime esenciale.

Kur IPA fondet përdoren për projekte banuese, është e nevojshme që aktivitetet dhe buxheti të planifikohen shumë përpara dhe në detaje. Vetëm kjo qasje do të ndihmojë që të minimizohen shpenzimet e paplanifikuara të cilat duhet të barten nga pushtetet lokale ose kombëtare. Nga shqyrtimi i PHARE dhe IPA projekteve në Kroaci, mund të shihet se ka progres në minimizimin e shpenzimeve të paplanifikuara:

	Fonde të BE (euro)	**Kontributi i Kroacisë (euro)**	**Shpenzime tjera (Kroaci, euro)**
PHARE 2005	470,000	157,000	700,000

[5] Lokacione të banuara nga romët – kushtet aktuale dhe mundësitë zhvillimore për vendbanimet dhe përmirësimi i kushteve për banim dhe jetës së romëve në Kroaci, Zagreb, 2005.

PHARE 2006	2,472,000	975,000	400,000
IPA 2008	1,971,000	733,000	215,000 deri më shtator 2012
IPA 2012	900,000	100,000	Mbetet për tu shqyrtuar

Komunat gjithashtu kanë qasje në fondet për bashkënpunim ndërkufitar dhe duhet t'i përdorin për ndërtimin e kapaciteteve për zhvillim dhe zbatim të projekteve. Pas anëtarësimit edhe më shumë fonde bëhen të qasëshme, mirëpo kapaciteti absorbues në shumicën e shteteve është i ulët, në veçanti në vendet më pak të zhvilluara në nivel lokal.

- *Bashkëpunimi me shoqatat qytetare rome, ashkale dhe egjiptiane në programe banuese/ rivendosëse*, Z. Arsim Nimanaj, zëvendës drejtor i Programit, Bashkimi Evropian – Mitrovicë/a, Iniciativë Përkrahëse për Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët (EU-MRSI), Mercy Corps

  Qëllimi i këtij projekti është rivendosja e 90 familjeve RAE nga kampet e kontaminuara në *Çeshmin lug* dhe *Osterode* në (ish) mëhallën rome në Mitrovicën Jugore dhe mbyllja e përhershme e të dy kampeve. Banimi është vetëm një nga gjashtë komponentat e projektit – gjithashtu është edhe ajo për edukim, zhvillim ekonomik, kujdes shëndetësor etj. Nga ana e komunës, Mercy Corps, UNHCR, OSBE, liderët e bashkësisë dhe nga Qendra Dokumentuese e Romëve dhe Ashkalinjëve, u krijua një grup këshillues i kampit. Ato u pajtuan se shtëpitë në varg janë më të preferueshme se blloqet me banesa. Në bazë të Manualit për Kthime të Qëndrueshme[6], u ndërtuan shtëpi në varg me madhësi të ndryshme (me një pjesë të madhësisë më të madhe prej 95m^2 e cila u shtua).

  Komunës së Mitrovicës iu dha toka dhe u nënshkruan kontrata trepalëshe për të drejtën e përdorimit për 99 vjet. Në plotësim, Mercy Corps nënshkroi një MpM me komunën për ta përvijuar bashkëpunimin në këtë projekt. Një aspekt i rëndësishëm i projektit ishte përzgjedhja e lokacionit adekuat për vendosjen – gjendet në distancë prej 5 minutave në këmbë nga qendra e Mitrovicës.

Procesi i shembjes

Vendbanimi Mahalla Rome në Mitrovicën Jugore

Vizita në teren

Takim me kryetarin e qarkut të Mexhimurjes dhe vizita e vendbanimit rom

Qarku Mexhimurje është vatër për popullatën më të madhe të romëve në Kroaci. Vlerësohet se rreth 11% e popullatës së këtij qarku janë rom. Qarku i Mexhimurjes konkludoi se shumica e popullatës rome ka kushte jo adekuate për jetesë: qoftë si rezultat i mungesës së infrastrukturës në vendbanimet rome ose mungesës së kushteve adekuate të shtëpive individuale.

Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakë gjatë vizitës së qytetit të Sisakut, Kroaci

[6] Ministria e komuniteteve dhe e kthimit,
Manual për kthim të qëndrueshëm, i rishqyrtuar në korrik 2006,
http://www.mkk-ks.org/?page=2,42&archive=true

Së bashku me Zyrën Qeveritare për Pakica Kombëtare, qarku i Mexhimurjes siguroi fonde për një sërë projekte infrastrukturore dhe banuese, duke përfshirë:

- "Rindërtimi i rrejtit infrastrukturor (ujë, kanalizim dhe energji elektrike) në vendbanimin Parag" (PHARE 2005);
- "Rindërtim i rrjeteve infrastrukturore në vendbanimet Pribislavec, Pishkorovec dhe Lonçarevo" (PHARE 2006);
- "Rindërtim i rrjeteve infrastrukturore në vendbanimet Orahovica dhe Sitnice, dhe inicim i procesit të legalizimit" (IPA 2008).

Të tre projektet kishën për qëllim që ta përmirësojnë standardin e jetesës së bashkësive rome në qarkun Mexhimurje, si dhe integrim dhe përfshirje të mëtutjeshme të romëve.

Takim me kryetarin e komunës Sisak dhe vizitë në vendbanimin rom

Në vitin 2005, vendbanimi *Çaprashke poljane* në qytetin Sisak ishte një vendbanim joformal rom i ndërtuar në tokën e cila është në pronësi të Ndërmarrjes Pyjore Kroate. Ishte një tokë publiko-urbane dhe nuk ishte e planifikuar për tu përdorur për banim. Me qëllim që tu mundësohet një zgjidhje e qëndrueshme banuese 150 familjeve rome të cilët *Çaprashke poljane* e bënë shtëpinë e tyre, qyteti i Sisakut avokoi për transferimin e tokës nën vendbanimin rom, nga Republika e Kroacisë në atë të qytetit të Sisakut.

U bë një studim sociologjik dhe i njejti u fokusua në popullatën rome e cila jeton në qytetin e Sisakut, si dhe në vendbanimin *Çaprashke poljane*. Ky studim ishte baza për të kërkuar transferimin e pronësisë së tokës ku vendbanimi është i vendosur, nga shteti tek komuna. Pas këtij transferi, komuna miratoi një plan të ri urbanisitk të detajuar. Qyteti e riklasifikoi tokën nga të qenit publiko-urbane në tokë rezidenciale jopublike. Për këtë qëllim, komuna investoi 900,000 kuna (rreth 120,000 EUR). Një nga shkaqet kryesore se përse kjo përpjekje ishte e suksesshme është njohja e mirë e kornizës ligjore nga ana e stafit komunal.

Kjo e bëri qytetin që të mundësojë qasje formale në shërbimet infrastrukturore siqë janë uji, rryma elektrike dhe grumbullimi i mbeturinave. Më tej, një person nga stafi i komunës është i fokusuar në punën me bashkësinë rome. Autoritetet komunale zbatojnë aktivitete përfshirëse dhe kanë kontakte të drejtëpërdrejta me liderët e bashkësisë rome.

Aktualisht, banorët e vendbanimit rom në Sisak duhet të aplikojnë për legalizim. Kjo nuk mund të bëhet nga autoritetet komunale – kjo është një gjë të cilën romët duhet ta bëjne vetë. Për fat të keq, shkalla e përgjigjeve nga bashkësia rome është shumë e ulët dhe aplikacionet janë në një nivel jo të kënaqshëm. Për të fituar të drejta pronësie, romëve do tu kërkohet që ta blejnë tokën e tyre.

Përmbledhje e rekomandimeve të Komisionit Evropian për përmirësimin e banimit të romëve[7]

Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim e BE-së duke i përfshirë të gjitha qeveritë nga regjioni, organizoi disa konferenca të nivelit të lartë, gjë e cila solli një sërë konkludimesh dhe zotime. Përderisa rekomandimet janë qendisur sipas gjendjes në çdo vend, përmbledhja e ardhshme sjell çështje të cilat janë relevante për të gjitha qeveritë në regjionin e Ballkanit Perendimor:

Legalizim

- Vendbanimet joformale duhet të përfshihen në planet hapsinore komunale.
- Shpenzimet administrative për nxerrjen e dokumenteve të nevojshme për legalizimin e ndërtimeve joligjore duhet të hiqen për personat socialisht të prekshëm.
- Dhënia e tokës duhet të sigurohet nga komunat në mënyrë që të të themelohen vendbanime të qëndrueshme ligjore dhe/ose të legalizohen të ashtuquajturat "vendbanime joligjore".
- Komuniteti rom duhet më mirë të informohet për procedurat e nevojshme sipas Ligjit për Legalizimin e Ndërtimeve/Shtëpive Joligjore[8]. Zyra e Kadastrit dhe OJQ-të rome duhet të organizojnë punëtori për rritjen e vetëdijes tek komuniteti rom.

[7] Në bazë të çështjeve të cilat u identifikuan në seminaret e nivelit të lartë, të mbajtura nga Pierre Mirel, Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim, Komisioni Evropian, në vitin 2011 në të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perendimor, përveç Kroacisë. Shih pjesën "Dokumente referencë" lidhur me rekomandimet për secilën nga juridiksionet.

[8] Shumica e juridiksioneve në Ballkanin Perendimor kanë ndërmarrë hapa bazike për miratimin e ligjeve dhe strategjive të rëndësishme, të cilat do të mundësojnë formalizimin e shtëpive dhe vendbanimeve të ndërtuara ilegalisht. Në vitin 2006, Shqipëria e

Rialokim

- Autoritetet lokale përpara se të bëjnë rialokim ose dëbim nga vendbanimet joformale, duhet në mënyrë sistematike të organizojnë konsultime me komunitetet e prekura nga këto çështje.
- Në rast të dëbimit prej shtëpive, mundësimi i akomodimit zëvendësues për të gjithë personat në fjalë duhet të jetë detyrë e autoriteteve lokale.

Banim social

- Komunat duhet t'i intenzivojnë përpjekjet e tyre për të mundësuar banim social adekuat për familjet rome të cilat nuk kanë shtëpi ose nuk posedojnë kurrëfar prone. Ato duhet të sigurohen se shtëpitë e sapo ndërtuara janë të lidhura me shërbimet komunale.
- Metodologjia aktuale për përzgjedhjen e shfrytëzuesve të projekteve banuese duhet të rishqyrtohet për t'i qartësuar kriteret për përzgjedhje, dhe atë në bazë të mësimeve të marra nga eksperienca në të kaluarën, duke mbajtur një qasje të orientuar kah nevojat. Roli i komisioneve për përzgjedhjen e shfrytëzuesve, roli i qendrave për punë sociale dhe përfaqësuesve të romëve duhet të përvijohet në mënyrë të qartë.
- Për grupet e prekshme duhet të zbatohen programe banuese të specializuara dhe të larëmishme, të cilat e rrespektojnë llojllojshmërinë kulturore dhe evitojnë segregimin social.
- Duhet të krijohet një mekanizëm/organ i pavarur i cili do ta mbikqyrë zbatimin e projekteve banuese që nga fillimi deri në fund të zbatimit.
- Qeveria duhet të sigurojë fonde për ndërtimin e njësive banuese shtesë dhe përkrahje shtesë përmes buxheteve komunale dhe donatorëve për realizimin e programeve banuese.

Standarde të cilat duhet të merren parasysh: ***banimi adekuat*** *është diçka më tepër se vetëm kulm mbi kokë. Sipas UN-Habitat, "banimi adekuat" përfshin:*

- *Privatësi & ambient adekuat;*
- *Qasje fizike;*
- *Siguri adekuate;*
- *Siguri në të drejtat e pronësisë;*
- *Stabilitet strukturor & kohëzgjatje;*
- *Ndriçim, nxemje dhe ventilim adekuat;*
- *Infrastrukturë bazike: furnizim me ujë, kanalizim & kapacitete për menaxhimin e mbeturinave;*
- *Kualitet i përshtatshëm ekologjik & faktorë shëndetësor; dhe*
- *Lokacion adekuat dhe i qasëshëm lidhur me punën & shërbimet bazike*

- të gjithë këto duhet të jenë të qasëshme për një çmim të volitshëm.

Kushtet e jetesës

- Qeveria duhet ta sigurojë qasjen në ujë të pastërt dhe sanitim në vendet ku janë prezent komunitetet rome, ashkale dhe egjiptiane.
- Projektet banuese dhe infrastrukturore të cilat e targetojnë bashkësinë rome, duhet të kenë prioritet më të lartë sa i takon çështjes së buxhetimit.

---

miratoi Ligjin për Legalizim, Urbanizim dhe Integrim të Ndërtimeve Joformale. Në vitin 2009, Serbia miratoi Ligjin për Planifikim dhe Ndërtim me të cilin definohet legalizimi i objekteve të ndërtuara në mënyrë joligjore. Në vitin 2011, pasoi miratimi i Ligjit për Trajtimin e Objekteve të Ndërtuara në Mënyrë Joligjore në ish Rpublikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Ligji për Trajtimin e Objekteve të Ndërtuara Ilegalisht në Kroaci. Tani në Kroaci është duke u bërë miratimi i amandmaneve të Ligjit për Trajtimin e Objekteve të Ndërtuara Ilegalisht. Mali i Zi është në proces të miratimit të Ligjit për Legalizimin e Objekteve Joformale, ndërsa Kosova* është në proces të miratimit të Strategjisë për Rregullimin e Objekteve Joformale. Edhe pse në Bosnjë dhe Hercegovinë nuk ka legjislacion referues në nivel kombëtar, një numër i komunave kanë miratuar Vendim për Legalizimin e Objekteve të Ndërtuara në Mënyrë Joligjore.

Rekomandime nga Grupi Punues

Zgjidhje ligjore dhe politike për legalizimin dhe përmirësimin e vendbanimeve rome, raportuar nga Znj. Sanella Imamoviç, projekt menaxher, Catholic Relief Services, Bosnjë dhe Hercegovinë

- Si pikënisje, duhet të bëhet një analizë për kushtet bazike – kjo përfshin identifikimin e karakteristikave të objekteve banuese, çfarë do çështje ligjore dhe pronësie dhe bërja e kartës sociale për çdo amvisëri (në varësi të financave të disponueshme dhe të madhësisë së banimit).
- Rekomandohet që të miratohet një qasje e rregullimit të vendbanimeve të tëra duke miratuar një plan të detajuar rregullues (i cili mund të përfshijë edhe një sferë më të gjërë), se sa vetëm legalizimin e çdo objekti individualisht. Metoda paraprake është vërtetuar për të qenë një opsion i cili ka më pak punë administrative dhe më pak shpenzime. Pas kësaj është e nevojshme që toka të ndahet në parcela dhe të legalizohen objektet banuese.
- Për ta përkrahur procesin e legalizimit duhet të mundësohen subvencione dhe resurse të tjera. Komuniteti rom duhet të angazhohet në ndërtimin e banimit social ose infrastrukturës, me qëllim që të zhvillohet një ndjenjë më e madhe e pronësisë dhe përgjegjësisë.

Projektet për legalizim dhe banesa sociale duhet të shoqërohen me aktivitete tjera të cilat kanë të bëjnë me infrastrukturën sociale, përfshirë edhe qasjen në arsim, mbrojtje shëndetësore dhe punësim

- Në rast se disa vendbanime nuk mund tu nënshtrohen rregullave, në pajtim me Deklaratën e Vienës, largimi i objekteve banuese nuk duhet të pasojë para se të gjenden akomodime alternative për banorët.
- Avokimi publik dhe rritja e vetëdijes duhet të vazhdojnë me qëllim që të sqarohet rëndësia e legalizimit dhe përfitimet e mundshme.
- Çështja e regjistrimit civil duhet të shqyrtohet gjatë procesit të legalizimit për shkak se në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndikon në zgjidhjen e tij.
- Projektet për legalizim dhe banim social duhet të shoqërohen me aktivitete tjera të ndërlidhura me infrastrukturën sociale, duke përfshirë këtu edhe qasjen në arsim, kujdes shëndetësor dhe punësim. Integrimi i këtyre sektorëve duhet të përforcohet, me fjalë tjera: prindërit e fëmijëve të cilët me sukses e kryejn shkollën duhet të lirohen nga taksat e legalizimit.
- Qasja në mundësitë për punësim është esenciale për qëndrueshmërinë e vendbanimeve rome dhe projektet për banim social.
- Me qëllim të promovimit të integrimit të romëve të cilët përdorin banim social ose janë të rialokuar, është e dobishme që të themelohet një qendër për vëzhgimin e çdo shfrytëzuesi individualisht dhe bashkëpunimin e tij/saj me shërbimet relevante (punësim, arsim dhe kujdes shëndetësor). Ky lloj i mbikqyrjes dhe raportimit të detajuar dhe të rregulltë për kushtet e shfrytëzuesve, duhet të inkorporohet brenda projekteve të financuara nga donatorët që nga faza e përpilimit.

Iniciativa komunale për legalizimin dhe përmirësimin e vendbanimeve, raportuar nga Z. Dritan Shutina, drejtor ekzekutiv, OJQ, Ko-plan, Shqipëri

- Fjalët "sukses" dhe "praktika të mira" duhet të përdoren me kujdes, çdoherë duke konsideruar objektivat afatshkurtëra dhe afatgjata, si dhe rreziqet e segregimit.
- Promovimi i integrimit nuk duhet të çojë në asimilim. Karakteristikat kulturore dhe ato të tjera të cilat ekzistojnë në komunitetin rom, duhet të fitojnë mirënjohje. Disa karakteristika të cilat ne i marrim për të qenë kulturore, në fakt janë pasojë e kushteve socio-ekonomike.
- Qeveritë duhet tu kushtojnë kujdes "kurtheve" ligjore – fokusi në përshtatjen e ligjit ndaj nevojave dhe kushteve në të gjithë shtetin mund të çojë në përjashtimin e disa grupeve të margjinalizuara, siqë janë romët.
- Shpërndarja e tokës është një nga problemet primare në inicimin e projekteve për zhvillim urban.

Komuniteti rom nuk është subjekt në procesin e zhvillimit të politikave, por duhet të jetë partner dhe anëtar i tij.

- Ligjet krijohen për të arritur disa qëllime të caktuara, mirëpo sistemet e fuqishme mbikqyrëse janë thelbësore për t'i detektuar problemet në zbatim dhe pas një kohe të çojnë në përmirësimin e kornizës ligjore, në pajtim me nevojat reale në këtë sferë.
- Procesi i planifikimit urban duhet të jetë më shumë participativ, me qëllim që t'i përmbushi nevojat e komunitetit të tërë, duke i përfshirë edhe romët.
- Komuniteti rom nuk është subjekt, por duhet të jetë bashkëpuntor dhe anëtar në procesin e zhvillimit të politikave.
- Pushtetet lokale ballafaqohen me mungesën e resurseve financiare. Strategjitë kombëtare shpesh miratohen pa buxhetet e nevojshme për zbatimin e tyre.

Dokumente referencë

Ligje për legalizim:

- Qeveria e Shqipërisë, Ligji për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Joformale, 2006
- Qeveria e Serbisë, Ligji për Planifikim dhe Ndërtim, 2009
- Qeveria e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Ligji për Trajtimin e Objekteve të Ndërtuara Ilegalisht, 2011
- Qeveria e Kroacisë, Ligji për Trajtimin e Ndërtesave të Ndërtuara Ilegalisht, 2011 (aktualisht në proces të ndryshimit)
- Qeveria e Malit të Zi, Ligji për Legalizimin e Objekteve Joformale
- Qeveria e Kosovës*, Projekt-strategjia për Rregullimin e Vendbanimeve Joformale, 2012
- Bosnja dhe Hercegovina nuk ka ligj në nivel shtetëror, por disa komuna kanë miratuar vendime për legalizimin e objekteve të ndërtuara ilegalisht.
- Ministria e Komuniteteve dhe e Kthimit në Kosovë*, Manual për Kthime të Qëndrueshme, i Rishqyrtuar në qershor të vitit 2006, http://www.mkk-ks.org/?page=2,42&archive=true

Ligje për banim social:

- Qeveria e Kroacisë, Programi për Ndërtimin e Banimit me Financim Publik, 2001
- Qeveria e Shqipërisë, Ligji për Banimin Social, 2004
- Qeveria e Serbisë, Ligji për Banimin Social, 2009, dhe Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Banim Social, 2012
- Qeveria e Kosovës*, Ligji për Financimin e Programeve Speciale të Banimit, 2010
- Qeveria e Malit të Zi, Projekt-ligji për Banim Social, 2012
- Gjersa nuk është miratuar asnjë ligj formal për banimin social në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në vitin 2010 kjo qeveri miratoi Strategjinë Kombëtare për Uljen e Varfërisë dhe Përfshirjen Sociale, e cila trajtonte personat që përballen me përjashtim social në sektorin e banimit.
- Bosnja dhe Hercegovina nuk ka asnjë kornizë formale strategjike apo ligjore për banimin social, por qeveria ka realizuar disa projekte për zhvillimin e banimit social me mbështetje të Catholic Relief Services, UNDP dhe Hilfswerk Austria

Korniza ndërkombëtare:

- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1966, http://www2.ohchr.org/english/laë/cescr.htm
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, 1969. http://www2.ohchr.org/english/law/cerd.htm
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, 1979. http://www2.ohchr.org/english/law/cedaw.htm
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1990. http://www2.ohchr.org/english/law/crc.htm
- Plani i Veprimit i OSBE-së për Përmirësimin e Gjendjes së Komunitetit Rom dhe Sinti në Fushëveprimin e OSBE-së, 2003, http://www.osce.org/odihr/17554
- Këshilli i Evropës, *10 Parimet Themelore për Përfshirjen e Romëve*, 2011, http://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Resources/Documents/2011_10_Common_Basic_Principles_Roma_Inclusion.pdf
- Këshilli i Evropës, Rekomandimin Rec(2005)4 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për përmirësimin e kushteve banuese të romëve dhe udhëtarëve në Evropë, miratuar nga Komiteti i

Ministrave më 23 shkurt 2005 gjatë takimit të 916 të zëvendës ministrave, https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=825545

- Rekomandimi i Komisionerit për të Drejtat e Njeriut për zbatimin e të drejtës së banimit, Strasburg, 30 qershor 2009, CommDH(2009)5, https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1463737
- Deklarata e Vienës, miratuar nga Konferenca Botërore e të Drejtave të Njeriut në vitin 1993, http://www.unhcr.org/refworld/docid/3ae6b39ec.html

Konkludimet/rekomandimet e KE për çdo juridiksion (përveç Kroacisë):

- Konkludime operacionale nga Seminari për Përfshirjen e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane brenda Kornizave të Integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, 15 dhjetor 2011, Tiranë, të qasëshme në http://eeas.europa.eu/delegations/albania/documents/roma_concl_final.pdf
- Konkludime operacionale nga Seminari për Përfshirjen e Romëve: Rruga për Përparim për Bosnjën dhe Hercegovinën, 4 korrik 2011, Sarajevë, http://www.osce.org/odihr/91134
- Konkludime operacionale nga Takimi Punues për Përfshirjen e Romëve dhe Refugjatëve Rom, 26 korrik 2011, Shkup, të qasëshme në http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Conclusions.pdf
- Konkludime operacionale nga Punëtoria për Përfshirjen e Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve, Persona të Dëbuar dhe Zhvendosur në Mal të Zi, 28 prill, Podgoricë, të qasëshme në http://www.delmne.ec.europa.eu/upload/dokumenta/082011_avgust/CONCLUSIONS%20OF%20WORKSHOP%20ON%20INCLUSION%20OF%20ROMA,%20ASHKALI%20AND%20EGYPTIANS%20DOMICILED%20AND%20DISPLACED%20PERSONS%20IN%20MONTENEGRO.pdf
- Konkludime operacionale nga Seminari për Përfshirje Sociale: Çështjet e Romëve në Serbi, 21-22 qershor, Beograd, të qasëshme në http://www.osce.org/odihr/91136
- Dyzet Aksione për ta Nxitur Zbatimin e Strategjisë dhe Planit Veprues për Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët, maj 2011, Prishtinë/a, e qasëshme në http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/111608-com-ko-rae-meeting-recommendations_en.pdf

Raporte:

- Këshilli i Evropës, 10 Parimet bazike për përfshirjen e romëve, 2011, http://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Resources/Documents/2011_10_Common_Basic_Principles_Roma_Inclusion.pdf
- Fresno, Jose Manuel, Çfarë funksionon për përfshirjen e romëve në BE, 2012, http://ec.europa.eu/justice/discrimination/files/whatworksfor_romainclusion_en.pdf
- UNDP, Hulumtim për gjendjen e romëve në 11 shtete anëtare të BE-së: Shkurt mbi rezultatet e hulumtimit, 2012, http://ec.europa.eu/justice/discrimination/files/whatworksfor_romainclusion_en.pdf
- CRS, Rekomandim për zhvillimin e banimit joprofitabil/social në B&H, tetor 2011
- Qeveria e Serbisë, Udhëzime për përmirësimin e legalizimit të vendbanimeve joformale rome. http://www.romadecade.org/files/downloads/14th%20ISC/Guidelines%20ISC%204-5%20Sept%2008%20Macura.pdf
- Misioni i OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë, Raport mbi vendbanimet joformale rome në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2003, f. 3. http://www.osce.org/node/14860
- OSBE, Banimi dhe vendbanimet rome në Evropën Jug-perendimore, 2006, http://www.osce.org/odihr/23336